

Aplikim për Programim Regjistrimi

Shtetasi i vendit të tretë (ShVT), duke hyrë në faqen e Ministrisë së Migracionit dhe Azilit mund të futet në faqen fillestare të Aplikimit për Programim Regjistrimi (Figura 1).




Figura 1: Faqja fillestare e Aplikimit Elektronik për Programim Regjistrimi

Djathtas lart, mund të zgjedhë gjuhën që dëshiron duke klikuar mbi GREEK për të zgjedhur gjuhën që dëshiron (Figura 1).

Nëse ShVT klikon mbi **DEPOZITIM APLIKIMI** ose mbi **APLIKIM I RUAJTUR**, do të shfaqet mesazhi (Figura 2).




Figura 2: Mesazh për lidhjen

Duke klikuar mbi ikonën [Lidhje](#) drejtohet tek faqja e lidhjes. (Figura 3)




Figura 3: Faqja e lidhjes

Në këtë pikë ShVT, do të duhet të plotësojë email-in e tij dhe të klikojë mbi butonin [Verifikim](#). Në vijim do të marrë një mesazh në email-in e tij nga otp-no-reply@migration.gov.gr, me një kod verifikimi, të cilin do të duhet të plotësojë në kuadratin bosh (Figura 4).

Kjo procedurë do të duhet të ripërsëritet çdo herë që do të dëshirojë të hyjë në aplikacion.





Figura 4: Plotësimi i kodit të verifikimit

Në vazhdim do të duhet të zgjedhë butonin [Hyrje](#) me qëllim që të drejtohet në faqen e parë të aplikacionit, tek faqja e aplikimit (Figura 5), në të cilën do të duhet të plotësojë disa të dhëna të caktuara identifikimi, të dhëna komunikimi, mënyrën e hyrjes në Greqi dhe të dhëna për sa i përket takimit si: pikën dhe gjuhën që dëshiron të regjistrohet si dhe numrin e anëtarëve të rritur dhe minorenë të familjes së tij. Nëse ShVT ka ruajtur kërkesën në një vizitë të tij të mëparshme në platformë, do të shfaqet menjëherë faqja e aplikimit të përkohshëm (Figura 6)

Djathtas lart ShVT mund të shohë që është i lidhur me email-in që përdori më parë

Aplikim i ri


Kërkesë për programim regjistrimi

Kutitë e detyrueshme janë të shënuara me *. Duke klikuar simbolin  në krah të çdo kutie shfaqen udhëzime plotësimi.


Duke klikuar 'Ruaj', aplikimi juaj do të ruhet përkohësisht. Është i mundur përpunimi i aplikimit në hyrje tuaj të ardhshme në aplikacion deri në depozitimin e tij përfundimtar.


Nëse dispononi Shënim Shërbimi nga autoritetet policore Greke, plotësoni të dhënat tuaja të identifikimit saktësisht siç shkruhen në të.


Të dhëna identifikimi


Dispononi Shënim Shërbimi? 


Nr. I pararegjistrimit (me vullnet të lirisë)


Emri* 


Mblemri* 

Emri i babait* 


Datëlindja* 

Gjinia* 


Nënshtetësia* 


Numri I pasaportës 

Komunikimi


Telefon celular 


Hyrje në Greqi


Mënyra e hyrjes* 


Pika e hyrjes 

Takim për regjistrim

Pikë regjistrimi* 

Gjuha e regjistrimit* 

Anëtarët e rritur të familjes* 

Anëtarë minorene të familjes* 

Ruajtje

Le mëparshme

Figura 5: Faqja kryesore e aplikacionit- Aplikimi

Sapo të përfundojë procedurën do të duhet të zgjedhë butonin Ruajtje, për t'u drejtuar në faqen e Aplikimit të Përkohshëm (Figura 6.)

APLIKIM I PËRKOHSHËM #95

Kërkesë për programim regjistrimi

Klikoni lidhjen (link-un) "Përpunim aplikimi" për të ndryshuar të dhënat që keni plotësuar.


Klikoni lidhjen (link-un) "Depozitim përfundimtar aplikimi" për të përfunduar kërkesën tuaj. Kujdes! Pas depozitimit përfundimtar nuk do të jetë i mundur mundshëm përpunimi i aplikimit.

Veprime	Përpunimi i aplikimit Depozitim përfundimtar Anulim i aplikimit
Të dhëna identifikimi	
Dispononi Shënim Shërbimi?	PO
Nr. i pararegjistrimit (me vullnet të lirë)	123456
Emri	TEST
Mbiemri	TESTEST
Emri i babait	ESTEST
Datëlindja	01/01/1980
Gjinia	MASHKULL
Nënshtetësia	Bangladesh
Numri i pasaportës	ABC123456
Komunikimi	
Telefon celular	6911111111
Hyrje në Greqi	
Mënyra e hyrjes	Nga deti
Pika e hyrjes	Mytilini
Takim për regjistrim	
Pikë regjistrimi	MALAKASA: Malakasa Facility, CAMP 'GERAKINI', 19011 MALAKASA
Gjuha e regjistrimit	ALBANIAN (SHQIP)
Data e regjistrimit	-
Ora e regjistrimit	-
Numri i referencës	-
Anëtarët e rritur të familjes	2
Anëtarë minorene të familjes	1

Figura 6: Faqe e Aplikimit të Përkohshëm

Në kutinë e veprimeve ShVT ka tre zgjedhje:

- duke zgjedhur [Përpunimi i aplikimit](#), ShVT mund të përpunojë të dhënat që deklaroi më parë dhe do të drejtohet sërish në faqen fillestare (aplikim) të aplikacionit.
- duke zgjedhur [Depozitim përfundimtar](#), ShVT mund të depozitojë përfundimisht aplikimin e tij dhe

- duke zgjedhur  Anulim i aplikimit , i jepet mundësia të anulohet aplikimin që depozitohet (Figura 6) dhe të fillojë një të ri nga fillimi.

Pasi ShVT të zgjedhë butonin e Depozitimit Përfundimtar, do të drejtohet tek faqja e Depozitimit Përfundimtar (Figura 7).

Depozitim përfundimtar

Kërkesë për programim regjistrimi

Duke zgjedhur 'Depozitim' do të vendoset data dhe ora për regjistrimin tuaj të plotë në pikën që zgjidhet dhe për gjuhën që zgjidhet dhe nuk do të ekzistojë më mundësia e përpunimit të të dhënave të aplikimit.

Procedura e regjistrimit do të zgjasë nga 1 deri në 25 ditë dhe gjatë kësaj periudhe kërkohet qëndrimi juaj në Qendër.

Në rast se nuk bëhet i mundur tranzicioni juaj në pikën e regjistrimit sipas takimit të paracaktuar, ju keni të drejtën e riprogramimit edhe 2 herë të tjera, pa pasur mundësi për një shtyrje tjetër

Pikë regjistrimi

MALAKASA

Gjuha e regjistrimit

ALBANIAN (SHQIP)

Anëtarë të rritur të familjes

2

Anëtarë minorene të familjes

1

Depozitim

I,e mëparshme

Figura 7: Faqja e Depozitimit Përfundimtar

Së fundmi, ShVT, për të depozituar përfundimisht aplikimin, mjafton të zgjedhë butonin **Depozitim**. Përndryshe duke zgjedhur butonin **I,e mëparshme**, i jepet mundësia të kthehet në faqen e Aplikimit të Përkohshëm. Sapo të depozitohet përfundimisht aplikimin e tij, do të shfaqet mesazhi **«Aplikimi juaj është depozituar përfundimisht»**.

Në vijim do të shfaqet edhe faqja e Aplikimit Përfundimtar (Figura 8)

APLIKIM PËRFUNDIMTAR #95

Kërkesë për programim regjistrimi

Kërkesa është përfundimtare

Klikoni lidhje 'Shkarkim dëshmie' për të marrë të dhënat kryesore të kërkesës suaj në email-in tuaj.

Veprime	Marrja e vërtetimit (dëshmisë)
Të dhëna identifikimi	
Dispononi Shënim Shërbimi?	PO
Nr.i pararegjistrimit (me vullnet të lirë)	123456
Emri	TEST
Mbiemri	TESTEST
Emri i babait	ESTEST
Datëlindja	01/01/1980
Gjinia	MASHKULL
Nënshtetësia	Bangladesh
Numri i pasaportës	ABC123456
Komunikimi	
Telefon celular	6911111111
Hyrje në Greqi	
Mënyra e hyrjes	Nga deti
Pika e hyrjes	Mytilini
Takim për regjistrim	
Pikë regjistrimi	MALAKASA: Malakasa Facility, CAMP 'GERAKINI', 19011 MALAKASA
Gjuha e regjistrimit	ALBANIAN (SHQIP)
Data e regjistrimit	20/07/2022
Ora e regjistrimit	10:00
Numri i referencës	11881
Anëtarët e rritur të familjes	2
Anëtarë minorene të familjes	1

Figura 8: Faqja e Depozitimit Përfundimtar

Nga faqja e aplikimit përfundimtar, ShVT duke zgjedhur veprimin [Marrja e vërtetimit \(dëshmisë\)](#), do të drejtohet tek faqja e dëshmisë së Aplikimit Përfundimtar (Figura 9). Duke zgjedhur butonin «**Shkarkim dëshmie**», do të dërgohet dëshmia e takimit të tij në email-in që deklaroi në fillim, ndërsa duke zgjedhur butonin «**I, e mëparshme**» do të drejtohet tek faqja e aplikimit përfundimtar.

DËSHMI E APLIKIMIT PËRFUNDIMTAR
Kërkesë për programim regjistrimi

Duke klikuar Shkarko do të merrni dëshminë e depozitimit të aplikimit në e-mail-in që deklaruat.

Figura 9: Dëshmia e Aplikimit Përfundimtar

Në çdo moment ka mundësinë për t'u shkëputur duke klikuar mbi ikonën e lidhjes, në të cilën do të shfaqet mesazhi **«Jeni shkëputur nga aplikacioni»**.

Paralelisht, mund të lidhet sa herë që dëshiron me mënyrën që u lidh edhe herën e parë.